

Eppc kërkon një **Audit të brendshëm** për klientin e saj, një ndër kompanitë e para në import dhe distribucion në Shqipëri dhe ndër më të mëdhatë në vend.

## Qëllimi i pozicionit:

Auditi i brendshëm do të kryejë kërkime dhe hetime procedurale, analiza dhe vlerësime që lidhen me funksionin e auditimit të brendshëm.

## Përgjegjësitë Kryesore:

- Analizon një departament apo njësi të e shoqërisë, me fokus të veçantë në Departamentin e Financës;
- Kontrollon, verifikon dhe vlerëson veprimtaritë e njësive të shoqërisë si dhe punën individuale të punonjësve për të përcaktuar përputhshmërinë me rregulloret, standardet, procedurat dhe politikat e shoqërisë;
- Zhvillon dhe menaxhon sistemin e informatizuar të regjistrimit dhe raportimit të auditit të brendshëm;
- Kryen kontrole dhe verifikime të procedurave të ndjekura gjatë proceseve të punës në çdo njësi të shoqërisë , përpilon raportet përkatëse dhe bën sugjerime;
- Bashkërendon dhe menaxhon angazhimin e njësive apo punonjësve përkatës në procesin e kryerjes së auditimit të brendshëm;
- Mbledh, analizon dhe vlerëson të dhënat e siguruar gjatë procesit të auditimit dhe përpilon raporte informative për drejtuesit e shoqërisë;
- Ndjek dhe kontrollon zbatimin e vendimeve të auditimeve të mëparshme , të miratuara nga drejtuesit.

## Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në Fakultetin Ekonomik, preferohet dega Financë –Kontabilitet;
- Eksperiencë 5 vjeçare në fushën e Financës dhe 3 vjeçare në Auditim;
- Aftësi analitike, raportimi dhe komunikimi shumë të mira;
- Aftësi kompjuterike ; njohje shumë e mirë e Programeve të MS Office.

## Të dhënat:

<b>Pozicioni:</b>	Audit i brendshëm;
<b>Vendndodhja:</b>	Tiranë;
<b>Pagesa:</b>	Në nivel shumë të mirë;
<b>Kontrata:</b>	Sipas Kodit të Punës;
<b>Aplikimet mbyllen:</b>	02.10.2017.

## Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mailit:

[recruitments@eppc.al](mailto:recruitments@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.